



VJE TË R

HARTA E RE GJYQËSORE DHE (MOS)AKSESI NË GJYKATË

RAPORT MONITORIMI

Maj-Korrik 2023



QENDRESA QYTETARE



NED NATIONAL ENDORSEMENT FOR DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

GRANDE

www.qeverisja.qq.com.al

AUTOR
DHIMITËR ZGURO

TABELA E PËRMBAJTJES

1. ORGANIZIMI GJYQËSOR NË KËNDVËSHTRIM HISTORIK	3
2. ORGANIZIMI GJYQËSOR PAS REFORMËS NË DREJTËSI	4
2.1 Procedura dhe kriteret ligjore mbi organizimin e rretheve gjyqësore	4
2.2 Harta e re gjyqësore dhe procesi i miratimit të saj	6
3. PROBLEMATIKAT E NJË HARTE GJYQËSORE	7
3.1 Aksesi i qytetarëve në drejtësi	7
3.1.1 Aksesi i qytetarëve në gjykimet e shkallës së dytë	10
3.2 Rritja e kostove	11
3.2.1 Rritja e kostove për buxhetin e shtetit	13
REKOMANDIME	13
BIBLIOGRAFIA	14

1. ORGANIZIMI GJYQËSOR NË KËNDVËSHTRIM HISTORIK

Në Shqipëri, deri më datën 22 nëntor 2016, pushteti gjyqësor u organizua në bazë të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.¹ Ky ligj u shfuqizua me miratimin, në kuadër të paketës së ligjeve të reformës në drejtësi, të ligjit nr. 98/2016, datë 6.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.²

Në referim të nenit 135, të Kushtetutës dhe ligjit, qoftë atij të shfuqizuar, qoftë atij në fuqi, pushteti gjyqësor në Shqipëri ushtrohet nga Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit, si edhe nga gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.³ Sipas ligjit të vjetër, gjykatat e shkallës së parë përfshinin gjykatat e rretheve gjyqësore dhe gjykatat e krimeve të rënda, kurse ato të apelit përfshinin si gjykatat e apelit, ashtu edhe gjykatat e apelit të krimeve të rënda.⁴

Një nga ndryshimet më thelbësore që lidhet me organizimin e gjykatave është mënyra dhe organi që përcakton kompetencën tokësore të gjykatave. Kështu, në referim të nenit 6, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, kompetencat tokësore të gjykatave dhe qendra, se ku këto gjykata do ta ushtronin veprimtarinë e tyre, caktohej me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë. Ky i fundit përpara se t’i përcillte Presidentit të Republikës propozimet përkatëse, duhej që fillimisht të konsultohej dhe të merrte mendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Sipas ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli ishte autoriteti shtetëror përgjegjës për mbrojtjen, emërimin, transferimin, shkarkimin, edukimin, vlerësimin moral e profesional, karrierën dhe për kontrollin e veprimtarisë së gjyqtarëve.⁵

Me Dekretin nr. 6201, datë 8.6.2009 “Për përcaktimin e kompetencave tokësore të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë të secilës prej tyre”, Presidenti i Republikës, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, kishte përcaktuar se gjykatat e rretheve gjyqësore organizohen në 22 rrethe gjyqësore.⁶ Ndërsa me

¹ Ligj nr. 9877, datë 22.11.2008, Fletore Zyrtare Nr. 27, datë 29.2.2008.

² Ligj nr. 98/2016, datë 6.10.2016, Fletore Zyrtare Nr. 209, datë 7.11.2016.

³ Po aty.

⁴ Ligj nr. 9877, datë 22.11.2008, Fletore Zyrtare Nr. 27, datë 29.2.2008.

⁵ Ligj nr. 8811, datë 17.5.2001, Fletore Zyrtare Nr. 9, datë 21.4.2002.

⁶ Dekret nr. 6201, datë 8.6.2009, Fletore Zyrtare Nr. 101, datë 8.7.2009.

Dekretin nr. 6217, datë 7.7.2009, Presidenti i Republikës, përcaktoi se gjykatat e apelit do të organizoheshin në gjashtë zona.⁷

Me miratimin e ligjit nr. 98/2016, mënyra e përcaktimit të kompetencave tokësore ndryshoi. Kështu, ndërsa ligji nr. 96/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" përcakton qartazi kompetencën tokësore të Gjykatës së Lartë, kompetencën tokësore të gjykatave të juridiksionit të posaçëm, kompetencën tokësore të Gjykatës Administrative të Apelit, ai shprehet se, organizimi i rretheve gjyqësore dhe kompetencave të tyre tokësore bëhet me miratimin e Këshillit të Ministrave, me propozim të përbashkët nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministri i Drejtësisë.⁸

Sipas pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr 96/2016, Këshilli i Lartë Gjyqësor, duhet të bëjë një vlerësim të organizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave të paktën çdo pesë vjet.⁹ Në këtë kontekst ligjor, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 495, datë 21.7.2022 "Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave".¹⁰

2. ORGANIZIMI GJYQËSOR PAS REFORMËS NË DREJTËSI

2.1 Procedura dhe kriteret ligjore mbi organizimin e rretheve gjyqësore

Në ndryshim nga ligji i mëparshëm, ligjvënësi, në ligjin nr. 98/2016, është treguar mjaft i vëmendshëm duke përcaktuar objektivat që duhet të ndiqen në caktimin e kompetencave tokësore, si dhe kriteret e parimet, që duhet të ndiqen për përcaktimin e kompetencave.

Kështu, në referim të nenit 14, të ligjit nr. 98/2016, kompetencat tokësore duhet të caktohen duke synuar përmbushjen në mënyrë të ekuilibruar të objektivave që lidhen: (i) së pari, me garantimin e aksesit në drejtësi, që lidhet me afërsinë e individit me gjykatën; (ii) së dyti, me uljen e kostove, me qëllim përdorimin me efektshmëri të burimeve publike; dhe (iii) së treti, me rritjen e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve të ofruara.¹¹

Përsa i takon parimeve në përcaktimin e kompetencave tokësore, legjislatori, në nenin 15, të ligjit nr. 98/2016, ka sanksionuar se njësia ku

⁷ Dekret nr. 6217, datë 7.7.2009, Fletore Zyrtare Nr. 103, datë 13.7.2009.

⁸ Ligj nr. 98/2016, datë 6.10.2016, Fletore Zyrtare Nr. 209, datë 7.11.2016.

⁹ Po aty.

¹⁰ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.7.2022, Fletore Zyrtare Nr. 107, datë 21.7.2022.

¹¹ Ligj nr. 98/2016, datë 6.10.2016, Fletore Zyrtare Nr. 209, datë 7.11.2016.

funksionojnë gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm është rrethi gjyqësor, i cili mund të mbulojë një ose më shumë njësi të pushtetit vendor. Përsa i takon parimeve, ligji ka përcaktuar se, gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe ato të posaçme, i shtrijnë kompetencat e tyre tokësore mbi të paktën dy rrethe gjyqësore.¹²

Në vijim, ligji përcakton mënyrën sesi ndahen rrethet gjyqësore dhe kompetencat tokësore përkatëse. Kështu, në mënyrë të njëjtë dhe të përshtatshme, sipas pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 98/2016, në përcaktimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave mbahen në konsideratë kriteret e mëposhtme:

- (i) ndarjen administrative territoriale të vendit, zhvillimin demografik, numrin e banorëve në raport me numrin e gjykatave, zhvillimin ekonomik, infrastrukturën rrugore dhe kushtet e transportit për në gjykata dhe midis gjykatave, si dhe karakteristikat gjeografike;
- (ii) ngarkesën në gjykata, në lidhje me çështjet e ardhura, të përfunduara dhe në shqyrtim, efikasitetin e gjykatave dhe gjyqtarëve në dhënien e drejtësisë, burimet njerëzore në dispozicion, vendndodhjen dhe përmasat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.¹³

Sikundër është shprehur dhe më lart, mbi Këshillin e Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 13, të ligjit nr. 96/2016, rëndon detyrimi për kryerjen e vlerësimit të rretheve gjyqësore.¹⁴ Ky vlerësim duhet të kryhet të paktën çdo pesë vite. Në rast se nga vlerësimi i kryer nga ana e KLGJ-së do të rezultojë se, harta gjyqësore nuk përmbush as objektivat e sipërpërmendura, as parimet dhe kriteret për përcaktimin e kompetencave, atëherë Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministri i Drejtësisë hartojnë një propozim të përbashkët për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave të gjykatave.¹⁵

Megjithatë, para miratimit të propozimit të përbashkët, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministri i Drejtësisë duhet të marrin mendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Ekonomisë dhe Financave, si dhe duhet të këshillohen me palë të tjera të interesuara, duke përfshirë këtu edhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë. Ky proces duhet të kryhet në mënyrë transparente duke marrë në konsideratë jo vetëm objektivat dhe parimet e përcaktuara

¹² Po aty.

¹³ Ligj nr. 98/2016, datë 6.10.2016, Fletore Zyrtare Nr. 209, datë 7.11.2016.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Po aty.

në ligjin nr. 98/2016, por edhe nevojën për vazhdimësi të shërbimeve gjyqësore, transferimin e personelit dhe organizimin e logjistikës.¹⁶

2.2 Harta e re gjyqësore dhe procesi i miratimit të saj

Më 18.02.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ngriti një Grup Ndërinstitucional për vlerësimin dhe riorganizimin e rretheve gjyqësore.¹⁷ Në shtator të 2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor publikoi raportin e vlerësimit të titulluar "Një hartë e re gjyqësore për Shqipërinë".¹⁸ Ky grup, siç shprehet dhe në Raportin e vlerësimit të publikuar dhe në Relacionin përkatës të KLGJ-së, vlerësoi se: "Harta gjyqësore në fuqi nuk i përmbush objektivat, parimet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 14 dhe 15 të Ligjit 98/2016, jo vetëm për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm e ato administrative të shkallës së parë, por edhe për gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm."¹⁹

Raporti vlerësues përfundimtar i Grupit Ndërinstitucional të Punës u miratua nga KLGJ më 10.6.2022, me dhjetë vota pro dhe një kundër.²⁰ Më pas, ky raport u miratua edhe nga KLP-ja²¹, Prokuroria e Përgjithshme²² dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Me vendimin nr. 495, datë 21.7.2022 "Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave", Këshilli i Ministrave vendosi që gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, dikur gjykatat e rretheve gjyqësore, të ishin vetëm 13 nga 22 që kishin qenë me Dekretin nr. 6201, datë 6.8.2009 të Presidentit të Republikës.²³

Më datë 1 maj 2023, hyri në fuqi riorganizimi i gjykatave duke bërë që, nëntë gjykata të shkriheshin. Kështu, u shkri Gjkata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, Gjkata e Rrethit Gjyqësor Përmet, Gjkata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, Gjkata e Rrethit Gjyqësor Mat, Gjkata e Rrethit Gjyqësor Pukë, Gjkata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, Gjkata e Rrethit Gjyqësor

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Këshilli i Lartë Gjyqësor, Relacion mbi projekt-aktin "Për miratimin e raportit vlerësues dhe propozimit të Grupit Ndërinstitucional të Punës mbi riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave". Për më shumë shih: <https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/06/relacion-harta-gjyqesore-F-1-Mbledhje-Plenare.pdf>, aksesuar për herë të fundit më datë 1.6.2023.

¹⁸ Për më shumë shih: <https://klgj.al/wp-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>, aksesuar për herë të fundit më datë 1.6.2023.

¹⁹ Po aty.

²⁰ Për më shumë shih: <https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/09/MBLEDHJE-E-KLGJ-S%C3%AB-Dat%C3%AB-10.06.2022-mbledhja-nr.2.pdf>, aksesuar për herë të fundit më datë 1.6.2023.

²¹ Për më shumë shih: <https://klp.al/wp-content/uploads/2022/07/Procesverbalit-dt.-27.06.2022.pdf>, aksesuar për herë të fundit më datë 1.6.2023.

²² Për më shumë shih: <https://shqiptaria.com/lajm/prokurori-i-pergjithshem-olsian-cela-iej-dakordesine-per-harten-e-re-gjyqesore-e-vleresojme-si-nevoje-emergjente>, aksesuar për herë të fundit më datë 1.6.2023.

²³ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.7.2022, Fletore Zyrtare Nr. 107, datë 21.7.2022.

Kurbin, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë.²⁴

Po ashtu, përmes këtij vendimi, u sanksionua që gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm do të organizoheshin në një Gjykatë Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm, që organizohet dhe funksionon në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në qytetin e Tiranës.²⁵ Gjykatat e apelit pushuan së ekzistuari më datë 1 shkurt 2023, datë në të cilën, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, u vendos në funksion Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm.²⁶

Riorganizimit, sipas vendimit nr 495, datë 21.7.2022, do t'i nënshtroheshin dhe gjykatat administrative të shkallës së parë. Kështu, këto gjykata do të riorganizoheshin në dy gjykata nga gjashtë, që kishin ekzistuar më parë në të gjitha zonat, ku ekzistonin dhe gjykatat e apelit, Të fundit, përsa i takon shkrirjes, ishin gjykatat administrative. Këto të fundit u shkrinë më 1.7.2023, ditë në të cilën, filloi punën Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata e Shkallës së Parë Lushnje.

3. PROBLEMATIKAT E NJË HARTE GJYQËSORE

Ndërsa Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm apo Ministria e Financave dhe Ekonomisë shprehën dakordësinë e tyre për miratimin e raportit për hartën gjyqësore, miratimi i këtij raporti gjeti kundërshtime nga qytetarët²⁷, avokatët, profesionistët e tjerë të ligjit²⁸, si dhe nga organizatat e shoqërisë civile.²⁹

3.1 Aksesi i qytetarëve në drejtësi

Qëllimi primar që duhet të mbahet në konsideratë në përcaktimin e kompetencave lidhet me garantimin e aksesit në drejtësi, në kuptim të afërsisë së individit me gjykatën.

Aksesi në drejtësi, ose siç njihet ndryshe e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, është një nga elementet më të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, që garantohet në nenin 42, të Kushtetutës së Republikës

²⁴ Po aty.

²⁵ Po aty.

²⁶ Po aty.

²⁷ Për më shumë shih: <https://shajptarja.com/lajm/proteste-kunder-hartes-se-re-gjyqesore-ne-shkoder-gjykatat-te-mos-hiqen-kosto-shtese-per-qytetaret>, aksesuar për herë të fundit më datë 1.6.2023.

²⁸ Për më shumë shih: https://fb.watch/kS_24V7r3L/, aksesuar për herë të fundit më datë 1.6.2023.

²⁹ Për më shumë shih: <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/02/Opinion-ligjor-Raporti-i-Vleresimit-per-Harten-e-re-Gjyqesore.pdf>, aksesuar për herë të fundit më datë 1.6.2023.

së Shqipërisë dhe në nenin 6, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Një nga aspektet, që përfshihen nën të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, është dhe e drejta për të filluar një proces gjyqësor.³⁰

Me të drejtë lind pyetja, se sa harta e re gjyqësore respekton aksesin në drejtësi, në kuptim të afërsisë me gjykatën. Për një përgjigje sa më të drejtë dhe që synon t'i përafrohet ligjvënësit, është e udhës të saktësojmë disa tregues, mbi bazën e të cilëve janë bërë dhe vlerësimet e skenareve të ndryshme për sa i takon riorganizimit gjyqësor.

Kështu, dy nga treguesit e mbajtur në konsideratë, distanca maksimale dhe koha maksimale e udhëtimit, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me aksesin në gjykatat përkatëse në metodologjinë e caktimit të gjyqtarit. Sipas përkufizimit të dhënë, distancë maksimale do të konsiderohet distanca më e madhe nga qyteti deri në gjykatë brenda rrethit gjyqësor.³¹ Njësoj si për distancën maksimale, ashtu edhe për kohën maksimale të udhëtimit që, përbën kohën më të gjatë të udhëtimit nga një njësi administrative për në gjykatë brenda rrethit gjyqësor, janë mbajtur në konsideratë për llogaritjen e këtyre treguesve vetëm qytetet që kanë shërbyer si njësi të pushtetit vendor, sipas ndarjes së mëparshme administrative.

Në Raportin e vlerësimit,³² por edhe në Relacionin e paraqitur,³³ është mbajtur qëndrimi se: *“Treguesit për distancën dhe kohën e udhëtimit janë matur kundrejt një standardi që konsiderohet i pranueshëm. Në fakt, nuk ka një konsensus në nivel botëror apo evropian lidhur me kuptimin e aksesit në drejtësi në aspektin e distancës, kohës së udhëtimit apo kostos së transportit për në gjykatën më të afërt. Mbështetur në raportet e kohëve të fundit, koha e udhëtimit deri në dy orë ose pak më shumë mund të jetë e pranueshme. Kjo është dhe koha optimale e marrë parasysh në vlerësimin e distancës midis vendeve më të largëta për qark për hartën e re gjyqësore.”*

Në vijim të sa më sipër, Grupi i Punës në Raportin e vlerësimit, ka mbajtur qëndrimin se: *“Megjithatë, do të përbente shkelje të rëndë të aksesit në drejtësi nëse për një qytetar nuk do të ishte e mundur që të*

³⁰ Çështja *Nait-Liman kundër Zvicrës* [DHM], aplikimi nr. 51357/07, datë 15.3.2018, para. 113.

³¹ Për më shumë shih: <https://klqi.al/wp-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>, aksesuar për herë të fundit më datë 1.6.2023.

³² Po aty.

³³ Këshilli i Lartë Gjyqësor, Relacion mbi projekt-aktin *“Për miratimin e raportit vlerësues dhe propozimit të Grupit Ndërinstitucional të Punës mbi riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”*. Për më shumë shih: <https://klqi.al/wp-content/uploads/2022/06/relacion-harta-gjyqesore-F-I-Mbledhje-Plenare.pdf>, aksesuar për herë të fundit më datë 1.6.2023.

mbërrinte në gjykatë, të ndiqte seancën dhe të kthehej në shtëpi brenda ditës (pra, duke iu dashur që të kalonte natën atje)".³⁴

Kështu, një banor i fshatit Miçan, në Njësinë Administrative Frashër (ish-Komuna Frashër), Bashkia Përmet, do t'i duhet që për të depozituar dhe filluar një proces gjyqësor të shkojë në Gjirokastër, ku ndodhet edhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Duke përdorur të njëjtin sistem³⁵, të cilin ka përdorur edhe Grupi Ndërinstitucional i Punës, rezulton se distanca mes Njësisë Administrative Frashër dhe qytetit Gjirokastër është rreth 104 km. Për të përshkruar këtë distancë, sipas sistemit, nevojiten 2 orë e 52 minuta.

Po t'i referohemi sistemit "e-transport",³⁶ të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rugor, i cili ofrohet dhe përdoret nga të gjithë aktorët e përfshirë në skemën e transportit ndërqytetës,³⁷ nga Përmeti në drejtim të Gjirokastrës, me linjë direkte, oraret e nisjes së transportit publik janë këto: 06:30 dhe 07:45. Ndërsa nga Gjirokastra, në drejtim të Përmetit, oraret e nisjes, me linjë direkte janë: 12:00 dhe 13:30.

Një banor i Njësisë Administrative Frashër megjithëse mund të arrijë në kohë për një seancë gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, ai nuk mund të kthehet në vendbanimin e tij, nëse seanca gjyqësore është planifikuar të zhvillohet në orën 13:00. Edhe sikur të jetë planifikuar më herët në kohë, seanca gjyqësore, për shkaqe të pavarura nga palët apo gjykata, mund të fillojë në një moment më të vonshëm. Në çdo rast, ky banor, për të aksesuar gjykatën e shkallës së parë, nuk do të mund të kthehej në shtëpi brenda të njëjtës ditë.

Megjithëse këtë rast, vetë Grupi Ndërinstitucional e ka konsideruar si një shkelje të rëndë të aksesit në drejtësi, sërish është vendosur që të shkrihet ish-Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe kjo e fundit të bashkohet me ish-Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, sot Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Situata bëhet më problematike përsa i takon aksesit në gjykatat administrative, aksesit i të cilave, në pikëpamje të distancës fizike, me

³⁴ Për më shumë shih: <https://klqi.al/wp-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>, aksesuar për herë të fundit më datë 1.6.2023.

³⁵ Për më shumë shih: <https://project-osm.org/>, aksesuar për herë të fundit më datë 1.6.2023.

³⁶ Për më shumë shih: <https://etransport.al/>, aksesuar për herë të fundit më datë 1.6.2023.

³⁷ Për më shumë shih: <https://etransport.al/news/23>, aksesuar për here të fundit më datë 1.6.2023.

mbyllen e katër gjykatave administrative, është bërë thuajse i pamundur që pas 1 korrikut.

Një qytetari nga Erseka, në rast se do të ndodhej përballë një konflikti administrativ, nga Korça, në rrethin gjyqësor administrativ të së cilës do të gjykohej çështja, tanimë për të paraqitur një kërkesëpadi apo për të ndjekur procesin gjyqësor do t'i duhet të paraqitet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Me të njëjtin sistem të përdorur edhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, rezulton se, distanca fizike mes Ersekës dhe Tiranës është rreth 202 km dhe përshkruhet për 4 orë e 27 minuta.³⁸ Ndërkaq, linja e vetme direkte, nga Erseka në drejtim të Tiranës, e ka nisjen në orën 12:30. Përsa i takon nisjes nga Tirana në drejtim të Ersekës, mundësitë e vetme, me linjë direkte, janë nisja në orën 06:00 ose në orën 14:30.³⁹ Duke mbajtur në konsideratë se linja e vetme direkte, nga Erseka në drejtim të Tiranës, e ka nisjen në orën 12:30, është e qartë se një qytetar nga kjo zonë, duhet të niset drejt Tiranës të paktën një ditë përpara. Dhe vetëm nëse seanca e tij është planifikuar të paktën para orës 14:00, ai mund të kthehet brenda të njëjtës ditë në banesën e tij, me ditën në të cilën është caktuar dhe gjykimi i çështjes.⁴⁰

3.1.1 Aksesit i qytetarëve në gjykimet e shkallës së dytë

Në Raportin e Vlerësimit përcaktohet se "Aksesi në gjykimin rishikues është i ndryshëm nga aksesit në juridiksionin fillestar. Në gjykimin rishikues në apel çështja është gjykuar tashmë një herë në themel dhe gjykata e apelit fokusohet më së shumti te shkaqet e ankimit. Ndryshimet ligjore procedurale në Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin e Procedurës Penale në vitin 2017 kanë rikonceptuar kufijtë e gjykimit në gjykatën e apelit, duke e kufizuar juridiksionin rishikues të gjykatës së apelit në shkaqet e ngritura në apelin e palës."⁴¹

Në vijim, në këtë Raport, mbahet qëndrimi se, aksesit në gjykatë nuk nënkupton vetëm marrjen e shërbimit pranë apo sa me afër vendbanimit, por marrjen e tij në një kohë sa më të shpejtë dhe efektive.⁴²

³⁸ Për më shumë shih: <https://project-osm.org/>, aksesuar për herë të fundit më datë 1.6.2023.

³⁹ Për më shumë shih: <https://etransport.al>, aksesuar për herë të fundit më datë 1.6.2023.

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ Për më shumë shih: <https://klqi.al/wp-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>, aksesuar për herë të fundit më datë 1.6.2023.

⁴² Po aty.

Problemi në lidhje me distancat fizike qëndron, gjithashtu, përse i takon dhe krijimit të një Gjykate Apeli me juridiksion të përgjithshëm në nivel kombëtar. Është e vërtetë se, krijimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm mund të ndikojë procesin e unifikimit dhe njehësimit të praktikës gjyqësore, por nga ana tjetër kjo Gjykatë, nuk mund t'i shërbejë efikasitetit dhe zvogëlimit të afatit kohor të çështjeve që "fleenë" në gjykatat e shkallës së dytë.⁴³

Kjo së pari, sepse, sipas standarteve ndërkombëtare të Komisionit European për Eficencën në Drejtësi (CEPEJ), gjykata nuk duhet të jetë shumë e madhe me një numër të madh gjyqtarësh të përqendruar në një gjykatë, sepse ndikon në uljen e produktivitetit të gjykatës.⁴⁴

Dhe së dyti, sepse, tanimë Gjykata e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm do t'i duhet të gjykojë çështjet e regjistruara pranë saj në bazë të datës në të cilën janë regjistruar. Aktualisht, pas mbylljes së gjykatave të tjera të shkallës së dytë, numri i dosjeve që priten të shqyrtohen në Gjykatën e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm është 32 000.⁴⁵ Kështu, një qytetar i Tropojës, i cili ka ankimuar një vendim në janar të vitit 2023 në Gjykatën e Apelit Shkodër, duhet që për të marrë një vendim të formës së prerë, të presë shqyrtimin e të gjitha çështjeve të regjistruara në Gjykatën e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm, të cilat kanë qenë rreth 21 mijë.⁴⁶ Ndërkohë që nëse Gjykata e Apelit Shkodër do të vijonte punën, qytetari mund të kishte një vendim të formës së prerë brenda 3 muajve, afat ky, i cili është vlerësuar si maksimal nga vetë Grupi Ndërinstitucional i Punës.⁴⁷

3.2 Rritja e kostove

Mbyllja e gjykatave të shkallave të parë rrit kostot për qytetarët. Kështu, një qytetari nga kostot për shpenzimet e transportit për nga vendbanimi deri në gjykatën, që do të kenë kompetencën tokësore për gjykimin e mosmarrëveshjes.

Kështu një banor i fshatit Vermosh, Njësia Administrative Kelmend, Bashkia Malësi e Madhe do duhet të përshkruajë rreth 191.5 km rrugë për të arritur në Tiranë, distancë e cila, sipas sistemit të përdorur nga ana e KLGJ-së, edhe për shkak të kushteve të rënduara infrastrukturore

⁴³ Po aty.

⁴⁴ Për më shumë shih: <https://www.reporter.al/2022/07/15/krijimi-i-nje-gjykate-te-vetme-apeli-cenon-shtetin-e-se-drejtjes/>, aksesuar për herë të fundit më datë 1.6.2023.

⁴⁵ Për më shumë shih: <https://www.zeramerikes.com/a/7025558.html>, aksesuar për herë të fundit më datë 1.6.2023.

⁴⁶ Po aty.

⁴⁷ Për më shumë shih: <https://klaj.al/wp-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>, aksesuar për here të fundit më datë 1.6.2023.

përshkruhet për rreth 4 orë e 51 minuta, për të aksesuar Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë apo Gjykatën e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm.

Duke qenë se Shqipëria nuk ka një transport publik të mirëorganizuar, vlen të theksojmë se, mënyrat apo edhe oraret e udhëtimeve janë të kufizuara. Këto kufizime, mund të passjellin mospasjen e mundësisë për t'u kthyer në banesë, në ditën që zhvillohet gjykimi, dhe për rrjedhojë, përkthehen në kosto shtesë për akomodim dhe ushqim.

Një tjetër kosto, lidhet edhe me shpenzimet për mbrojtësit apo profesionistët e tjerë ligjorë. Kostot e lidhura në këtë pjesë duhen parë në dy këndvështrime:

Së pari, tarifat e avokatëve, të cilët veprojnë në bazë të ligjit nr. 55/2018 *"Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë"*.⁴⁸ Shpërblimi i këtyre profesionistëve, si rregull, caktohet me marrëveshje ndërmjet avokatit dhe klientit. Kështu në rast se një klient nga Tropoja do të kontrakttojë një avokat, që profesionin e tij e ushtron në Tropojë, duhet që këtij avokati t'i mbulojë përveç shpenzimeve avokatore, edhe shpenzimet që lidhen me udhëtimin e avokatit nga Tropoja në gjykatën, në kompetencën e të cilës është gjykimi i mosmarrëveshjes konkrete.

Edhe sikur klienti, pavarësisht nga banimi i tij, të zgjedhë një mbrojtës, anëtar të Dhomës së Avokatisë Tiranë, sërish ai do duhet të paguajë më shumë, pasi tarifat e shërbimeve avokatore në Tiranë janë më të shtrenjta, në krahasim me ato të rretheve.

Së dyti, mbyllja e gjykatave dhe përqëndrimi i tyre në disa zona të caktuara, do të sjellë rritjen e përqëndrimit të avokatëve apo profesionistëve të tjerë ligjorë, si përmbauesit gjyqësorë privatë, që të përqëndrohen vetëm në ato vende ku ndodhen gjykatat. Një përqëndrim i tillë jo vetëm që do të çenojë shpërndarjen e këtyre profesioneve, por edhe do të rritë kostot e këtyre profesionistëve, të cilët, në fund do t'i "faturojnë" të gjitha kostot e tyre drejt rritjes së tarifave të shërbimit për klientët.⁴⁹

Kjo rritje e kostove, që në çdo rast, do t'i faturohet klientëve, pra qytetarëve, pengon në mënyrë thelbësore individin për t'ju drejtuar gjykatës. Kjo pasi kostoja e procedurave që pengon një individ t'i

⁴⁸ Ligj nr. 55/2018, datë 23.7.2018, Fletore Zyrtare Nr. 123, datë 17.8.2018.

⁴⁹ Për më shumë shih: <https://www.monitor.al/avokatet-kunder-padrejtesive-te-hartes-gjyqesore-2/>, aksesuar për herë të fundit më datë 1.6.2023.

drejtohet gjykatës, në raport me gjendjen e tij financiare, mund të dëmtojë aksesin në gjykatë.⁵⁰

3.2.1 Rritja e kostove për buxhetin e shtetit

Krijimi i një Gjykate Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm, me seli në Tiranë dhe që në organikën e saj ka 78 gjyqtarë, kërkon me domosdoshmëri ndërtimin e një godine të fillë, që të plotësojë të gjitha kërkesat dhe kushtet e nevojshme për akomodimin e të gjithë gjyqtarëve, nëpunësve civilë gjyqësore dhe të gjithë pjesës tjetër të stafit të Gjykatës. Kjo pasi, në kushtet aktuale, Gjykata e Apelit nuk ka kapacitete të tilla, si përsa i takon numrit të sallave të gjyqit, numrit të zyrave të gjyqtarëve apo edhe numrit të zyrave të shërbimit. Dhe për këtë arsye, është thuajse e pamundur që Gjykata të zhvillojë veprimtarinë e saj në kushte normale.

Nga ana tjetër, ndërtimi i një godine që do të plotësojë të gjitha nevojat e krijuara, është jo vetëm një proces i gjatë për nga pikëpamja kohore, por edhe mjaft i kushtueshëm, po të mbahen në konsideratë standardet që nevojiten në ndërtimin e gjykatave.

Në pikëpamje të kostove, do të rriten edhe kostot e buxhetit të shtetit mbi togat e shoqërimit, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilat duhet të shoqërojnë të paraburgosurit apo të burgosurit, apo të dënuarit në drejtim të gjykatave që ndodhen jashtë territorit, të njësisë administrative ku ndodhet institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale, apo në drejtim të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

REKOMANDIME

Së pari, harta gjyqësore duhet të rishikohet, veçanërisht, përsa i takon mbylljes së gjykatave të shkallës së dytë dhe gjykatave administrative. Gjatë këtij procesi duhet të mbahen në konsideratë, konteksti shoqëror dhe rrethanat objektive, duke përfshirë dhe infrastrukturën e vendit tonë. Përgjatë procesit të rishikimit, të përcaktohet qartazi në metodologjinë e punës, që distanca kohore, e cila do të konsiderohet si një distancë e pranueshme.

Së dyti, përpara miratimit të hartës gjyqësore, jo vetëm që duhet të dëgjohet mendimi i palëve të interesuara si avokatët apo

⁵⁰ Çështja *Aït-Mouhoub kundër Francës*, aplikimi nr. 103/1997/887/1099, datë 28.10.1998, para. 57 – 58; Çështja *Garcia Manibardo kundër Spanjës*, aplikimi nr. 38695/97, datë 15.2.2000, para. 38 – 45, cituar në Dokument Qëndrimesh "Dritëhijet dhe efektet e hartës së re gjyqësore", të hartuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Për më shumë shih: <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2023/02/Dritehijet-dhe-Efektet-e-Hartes-se-Re-Gjyqesore.pdf>, aksesuar për herë të fundit më datë 1.6.2023.

profesionistët e tjerë ligjorë, por mendimi i këtyre profesionistëve duhet të mbahet në konsideratë.

Së treti, një rekomandim tjetër që është kryer dhe nga ish-Ministri i Drejtësisë, Eduard Halimi, lidhet me përgatitjen e një studimi fizibiliteti për kostot e hartës gjyqësore. Në këtë studim, duhet të përfshihen kostot për hapësirat, godinat, sallat e gjyqit, projektet inxhinierike dhe ato të telekomunikacionit, transporti i të burgosurve, transferimi i personelit dhe burimeve njerëzore.⁵¹

BIBLIOGRAFIA

- “Avokatët, Kundër Padrejtësive Të Hartës Gjyqësore.” *Monitor.AL*, 8 June 2022, www.monitor.al/avokatet-kunder-padrejtësive-te-hartes-gjyqësore-2/.
- “Çela Jep Dakordësinë Për Hartën e Re Gjyqësore: E Vlerësojmë Si Nevojë Emergjente Për Përmirësim Në Sistemin e Prokurorisë! Dakord Dhe KLP.” *Shqiptarja.Com*, 27 June 2022, shqiptarja.com/lajm/prokurori-i-pergjithshem-olsian-cela-jep-dakordësine-per-harten-e-re-gjyqësore-e-vlerësojme-si-nevoje-emergjente;
- “DEKLARATË PUBLIKE Oponencë Ndaj Propozimeve Për Hartën e Re Gjyqësore Për Shqipërinë.” 11 Feb. 2022, ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/02/Opinion-ligjor_Raporti-i-Vlerësimit-per-Harten-e-re-Gjyqësore.pdf
- “Protestë Kundër Hartës Së Re Gjyqësore Në Shkodër: Gjykatat Të Mos Hiqen, Kosto Shtesë Për Qytetarët.” *Shqiptarja.Com*, 22 June 2022, shqiptarja.com/lajm/proteste-kunder-hartes-se-re-gjyqësore-ne-shkoder-gjykatat-te-mos-hiqen-kosto-shtese-per-qytetarët;
- Çështja *Ait-Mouhoub kundër Francës*, aplikimi nr. 103/1997/887/1099, datë 28.10.1998, para. 57 – 58;
- Çështja *Garcia Manibardo kundër Spanjës*, aplikimi nr. 38695/97, datë 15.2.2000, para. 38 – 45;
- Çështja *Naiit-Liman kundër Zvicrës* [DHM], aplikimi nr. 51357/07, datë 15.3.2018, para. 113;
- Dekret nr. 6201, datë 8.6.2009, Fletore Zyrtare Nr. 101, datë 8.7.2009;
- Dekret nr. 6217, datë 7.7.2009, Fletore Zyrtare Nr. 103, datë 13.7.2009;
- Dushi, Desara. *Krijimi i Një Gjykate Të Vetme Apeli Cenon Shtetin e Së Drejtës*, 15 July 2022,

⁵¹ Për më shumë shih: <http://www.panorama.com.al/harta-e-re-gjyqësore-probleme-te-reja-ne-drejtësi/>, aksesuar për herë të fundit më datë 1.6.2023.

www.reporter.al/2022/07/15/krijimi-i-nje-gjykate-te-vetme-apeli-cenon-shtetin-e-se-drejtës/;

- *eTransport*, etransport.al;
- Halimi, Eduard. "Harta e Re Gjyqësore, Probleme Të Reja Në Drejtësi." *Panorama.Com.AL*, 21 Jan. 2022, www.panorama.com.al/harta-e-re-gjyqesore-probleme-te-reja-ne-drejtësi/;
- *Harta e Re Gjyqësore Në Shqipëri, Shqetësime Për Kostot Dhe Vonesat Në Drejtësi*, www.zeriamerikes.com/a/7025558.html;
- Këshilli i Lartë Gjyqësor. "Një hartë e re gjyqësore". <https://klgj.al/wp-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>
- Këshilli i Lartë Gjyqësor. "Procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor". <https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/09/MBLEDHJE-E-KLGJ-s%C3%ab-Dat%C3%ab-10.06.2022-mbledhja-nr.2.pdf>;
- Këshilli i Lartë Gjyqësor. "Relacion Mbi Projekt-Aktin 'Për Miratimin e Raportit Vlerësues Dhe Propozimit Të Grupit Ndërinstitucional Të Punës Mbi Rirorganizimin e Rretheve Gjyqësore Dhe Kompetencave Tokësore Të Gjykatave.'" klgj.al/wp-content/uploads/2022/06/relacion-harta-gjyqesore-F-1-Mbledhje-Plenare.pdf;
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë. "Përmbledhëse e Procesverbalit Nr. 1782/2 Prot., Datë 28.07.2022." klp.al/wp-content/uploads/2022/07/Procesverbalit-dt.-27.06.2022.pdf;
- Komiteti Shqiptar i Helsnikit. *Dokument Qëndrimesh: Dritëhijet Dhe Efektet e Hartës Së Re Gjyqësore*, ahc.org.al/wp-content/uploads/2023/02/Dritehijet-dhe-Efektet-e-Hartes-se-Re-Gjyqesore.pdf;
- Ligj nr. 55/2018, datë 23.7.2018, Fletore Zyrtare Nr. 123, datë 17.8.2018;
- Ligj nr. 8811, datë 17.5.2001, Fletore Zyrtare Nr. 9, datë 21.4.2002;
- Ligj nr. 98/2016, datë 6.10.2016, Fletore Zyrtare Nr. 209, datë 7.11.2016;
- Ligj nr. 9877, datë 22.11.2008, Fletore Zyrtare Nr. 27, datë 29.2.2008;
- *Open Source Routing Machine*, project-osm.org/;
- *PËRGJIGJE NË VEND TË DHKA-SË PËR TË MOS QENË BURUNDI, MOZAMBIKU POR SHQIPËRIA*, 1 July 2022, www.facebook.com/NCHB.AL/videos/776333893359005/;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.7.2022, Fletore Zyrtare Nr. 107, datë 21.7.2022.

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al